Rhonda Byrne

F S H E H T Ë S I A

përmbledhje



Zgjodhi dhe përktheu

Ridvan Bunjaku

|:(|:)

Dhjetor 2013

PËRMBAJTJA

FSHEHTËSIA E NXJERRË NË SHESH 3

FSHEHTËSIA E THJESHTËSUAR 5

SI TA PËRDORËSH FSHEHTËSINË 9

PROCESE TË FUQISHME 11

APLIKIMET E FSHEHTËSISË 12

FSHEHTËSIA PËR PARATË 13

FSHEHTËSIA PËR MARRËDHËNIET (LIDHJET DHE MIQËSITË) 15

FSHEHTËSIA PËR SHËNDETIN 17

FSHEHTËSIA PËR BOTËN 19

FSHEHTËSIA PËR TY 20

FSHEHTËSIA PËR JETËN 22

INFO 25

FSHEHTËSIA E NXJERRË NË SHESH

- Fshehtësia e Madhe e Jetës është ligji i tërheqjes.
- Ligji i tërheqjes thotë **e ngjashmja e tërheq të ngjashmen**, pra kur e mendon një mendim, ti je duke tërhequr edhe mendime **të ngjashme** te ti.
- Mendimet janë magnetike, dhe mendimet kanë frekuencë. Ndërsa mendon mendime, ato dërgohen në Gjithësi, dhe ato i tërheqin magnetikisht të gjitha gjërat e ngjashme që janë në frekuencën e njëjtë. Gjithçka e dërguar kthehet te burimi – ti.
- Ti je si kullë njerëzore e transmetimit, duke e përhapur një frekuencë me mendimet e tua. Nëse dëshiron të ndryshosh diçka në jetën tënde, ndryshoje frekuencën duke i ndryshuar mendimet e tua.
- Mendimet e tua aktuale janë duke e krijuar jetën tënde në të ardhmen. Ajo për të cilën mendon më së shumti apo në të cilën përqendrohesh më së shumti do të shfaqet si jeta jote.
- Mendimet e tua bëhen gjëra.

Qëllimi Thelbësor i "Sekretit" është të të mësojë të arrish gjithçka që dëshiron përmes Ligjit të Tërheqjes.
Ky Ligj thotë se ajo çka mendon dhe ajo për çka ushqen ndjenja do të tërhiqet te ti.

Vendos se çka dëshiron në jetë, përqendroji mendimet e tua në atë gjë, ndjeje se e ke, vepro që ta pranosh kur ta gjuan Universi.

Sekreti nga Rhonda Byrne

Përdorimi i Sekretit -
Procesi Krijues -
Ktheje Fantazinë në Fakt -
Kalo në Fantazi më të mëdha

Bëje këtë përditë për të gjitha dëshirat e tua

Sekreti është Ligji i Tërheqjes

Tërheqja është rezultat
i mendimeve dhe i ndjenjave

Mendja është duke i formësuar
rezultatet e tua në kohë reale.

**Përqendrohu në atë që e do - kurrë mos u përqendro në atë që nuk e do.
Në vend të kësaj përqendrohu në të kundërtën e asaj që nuk e do.**

Tërhiqe atë që e do duke i ndryshuar mendimet dhe ndjenjat e tua tash. Udhëheqi mendimet e tua duke u bazuar në atë se si ndihesh me to për ta krijuar realitetin tënd

Kodi i ngjyrave

Këto janë esencat bazë.
Këto janë esencat përkrahëse.
Këto janë elemente të veprimit për ty.
Këto janë elemente të veprimit për të tjerët.

FSHEHTËSIA E THJESHTËSUAR

- Ligji i tërheqjes është ligj i natyrës. Ai është po aq i paanshëm sa ligji i gravitetit.
- Asgjë nuk mund të vijë në përjetimin tënd nëse nuk e fton përmes mendimeve të vazhdueshme.
- Për ta ditur se çka je duke menduar, pyete veten se si po **ndihesh**. Emocionet janë vegla të çmueshme që na tregojnë aty për aty, në çast, se çka jemi duke menduar.
- Është e pamundur të ndihesh keq dhe në të njëjtën kohë të kesh mendime të mira.
- Mendimet e tua e përcaktojnë frekuencën tënde, dhe ndjenjat e tua të tregojnë menjëherë se në çfarë frekuence je. Kur ndihesh keq, je në frekuencën e tërheqjes së më shumë gjërave të këqija. Kur ndihesh mirë, je duke tërhequr fuqishëm më shumë gjëra të mira te ti.
- Zhvendosësit e Fshehtë, siç janë kujtimet e këndshme, natyra, apo muzika jote e preferuar, mund t'i ndryshojnë ndjenjat e tua dhe ta zhvendosin frekuencën tënde në çast.
- Ndjenja e dashurisë është frekuenca më e lartë që mund ta emetosh (rrezatosh). Sa më e madhe dashuria që e ndjen dhe që e emeton, aq më e madhe fuqia që je duke e shfrytëzuar.

Sekreti është Ligji i Tërheqjes
I përgjigjet mendimeve dhe ndjenjave tua për ta krijuar të ardhmen tënde
Ligji më i fuqishëm në Univers
Të jep gjithçka që ti do
Është duke punuar gjithmonë pavarësisht nga besimi dhe të kuptuarit
Nuk i intereson për perceptimin tënd të të mirës apo të keqes as a do ti apo nuk do
Është bazë e gjithësisë - p.sh. graviteti


Tërheqja është rezultat i mendimeve dhe i ndjenjave
Mendimet e tua
Formojnë imazhe në mendje
Janë vazhdimisht duke krijuar dhe ato bëhen gjëra
Tri tipe
Të kujtuarit - e kaluara
Të vëzhguarit - e tashmja
Imagjinimi - e ardhmja
Çdokush mund t'i ndryshojë mendimet e veta thjesht veç duke e ndryshuar përqendrimin (fokusin)
Mendimi pozitiv shumë herë më i fuqishëm se sa mendimi negativ - Pra rezultatet pozitive prodhohen më shpejt
Mendimet marrin ca kohë për t'u manifestuar duke dhënë amortizim për korrigjim të kursit - drejtimit.
Ndjenjat e tua
Mendimet shkaktojnë ndjenja
Të Ndihesh Mirë domethënë bashkërenditje me atë që e duam dhe se jemi gati të pranojmë-marrim
Të Ndihesh Keq domethënë jo në bashkërenditje me atë që e duam dhe nuk jemi gati të pranojmë-marrim
Ndjenjat e tua i parapërcaktojnë rezultatet e tua
Janë Sistemet e tua Udhërrëfyese Emocionale

Mendja është duke i formësuar rezultatet e tua në kohë reale

- Çka je tash është rezultat i mendimeve dhe ndjenjave tua në të kaluarën
- Çka mendon dhe ndien tash do të përputhet me rezultatin tënd në të ardhmen
- Ajo në çka përqendrohesh, e deshte apo jo, manifestohet

Tërhiqe atë që e do duke i ndryshuar mendimet dhe ndjenjat e tua tash; Udhëheqi mendimet e tua duke u bazuar në atë se si ndihesh me to për ta krijuar realitetin tënd

Përqendrohu në atë që e do - kurrë mos u përqendro në atë që nuk e do. Në vend të kësaj përqendrohu në të kundërtën e asaj që nuk e do.

SI TA PËRDORËSH FSHEHTËSINË

- Sikur Xhindi i Aladinit, ligji i tërheqjes e pranon secilin urdhër tonin.
- Procesi Krijues të ndihmon ta krijosh atë që e dëshiron në tre hapa të thjeshtë: kërko, beso, dhe prano (merr).
- T'ia **Kërkosh** Universit atë që e dëshiron është shansi yt të qartësohesh për atë se çka dëshiron. Ndërsa qartësohesh në mendje, ti ke kërkuar.
- Të **Besosh** e përfshin veprimin, të folurit, dhe të menduarit sikur tashmë e ke pranuar atë që e ke kërkuar. Kur e emeton frekuencën 'tashmë e kam pranuar', ligji i tërheqjes i lëviz njerëzit, ngjarjet, dhe rrethanat që ti ta pranosh.
- Të **Pranosh** e përfshin të ndjehesh në mënyrën si do të ndjehesh pasi të jetë manifestuar (shfaqur) dëshira jote. Të ndihesh mirë tash të vendos në frekuencën e asaj që e dëshiron.
- Për të humbur peshë, mos u përqendro në "humbjen e peshës". Në vend të kësaj, përqendrohu në peshën tënde të përsosur. Ndjeji ndjenjat e peshës tënde të përsosur, dhe do ta ftosh atë te ti.
- Nuk merr aspak kohë për Gjithësinë ta manifestojë (shfaqë, realizojë) atë që e dëshiron ti. Është po aq lehtë të manifestohet një Euro (apo dollar) sa është lehtë të manifestohen një milion Euro (apo dollarë).
- Të nisësh me diçka të vogël, siç është një filxhan kafe apo hapësirat e parkimit, është mënyrë e lehtë ta përjetosh ligjin e tërheqjes në veprim. Syno fuqishëm të tërheqësh diçka të vogël. Ndërsa e përjeton fuqinë që e ke për të tërhequr, do të kalosh në krijimin e gjërave shumë më të mëdha.
- Krijoje ditën tënde paraprakisht duke e menduar mënyrën se si dëshiron ti të shkojë ajo, dhe do ta krijosh jetën tënde qëllimisht (me paramendim, me synim).


Mendo për atë që e do, formoji ndjenjat, shkruaje diku, fol për të, vëje në skenë (aktroje), përjetoje, bëje realitet tëndin.
Kërkoje atë që e do
Jini të përqendruar në dëshirën me plot pasion
Beso se mund ta kesh, se është e mundur, dhe se e meriton
Universi do të riaranzhohet (ripërshtatet) për ta dhënë përgjigjen
Mos u shqetëso se si
Universi do të përgjigjet
Nuk ka periudhë të caktuar kohore për përgjigjje
Mendja jonë i vendos kufijtë kohorë, jo universi
Shpreheni mirënjohjen duke e bërë një listë të gjërave për të cilat jeni mirënjohës
Çmuarja sjell më shumë përkrahje
Vizualizoje (përfytyroje, paramendoje) se e ke atë që e do dhe ndieji ndjenjat e posedimit të saj
Përdor Tabelë të Vizionit - Tabelë e thjeshtë në të cilën mund të vendosësh foto të gjërave që i dëshiron
Rri në ndjenjë të lumturisë për të tërhequr situata të mira
Ji gati për të pranuar
Ndryshoji ndjenjat e këqija shpejt duke menduar diçka të mirë
Përjetoje ndjenjën e posedimit tash duke e provuar, aktruar apo imagjinuar
Kur ke mendim të inspiruar, besoji dhe vepro në të
Kur shfaqet shansi, vepro me shpejtësi
Më shumë pasion dhe ndjenja të mira do ta shpejtojnë procesin
Bëje ambientin tënd të përputhet me dëshirat e tua
Përdorimi i Sekretit - Procesi Krijues - Ktheje Fantazinë në Fakt - Kalo në Fantazi më të mëdha
Bëje këtë çdo ditë për të gjitha dëshirat e tua

PROCESE TË FUQISHME

- Pritja të ndodhë është forcë e fuqishme tërheqëse. Priti të ndodhin gjërat që i dëshiron, dhe mos i prit gjërat që nuk i dëshiron.
- Mirënjohja është proces i fuqishëm për zhvendosjen e energjisë tënde dhe për të sjellë më shumë nga ato që i dëshiron në jetën tënde. Ji mirënjohës(e) për të që tashmë e ke, dhe do të tërheqësh më shumë gjëra të mira.
- Të falënderohesh paraprakisht për atë që e dëshiron i përshpejton dëshirat e tua dhe dërgon sinjal më të fuqishëm në Gjithësi.
- Vizualizimi (paramendimi, përfytyrimi, imagjinimi) është procesi i krijimit të pamjeve në mendjen tënde të vetes duke e shijuar atë që e dëshiron. Kur vizualizon, ti prodhon mendime dhe ndjenja të fuqishme të posedimit të saj tani. Ligji i tërheqjes pastaj ta kthen atë realitet, pikërisht si e ke parë atë në mendjen tënde.
- Për ta përdorur ligjin e tërheqjes në favorin tënd, bëje atë mënyrë të qenies që është shprehi (zakon), jo vetëm ngjarje që ndodh një herë.
- Në fund të secilës ditë, para se të shkosh të flesh, kthehu nëpër ngjarjet e ditës. Për çdo ngjarje apo moment që nuk ka qenë ashtu siç e dëshiroje, rishfaqe në mendjen tënde në mënyrën siç dëshiroje ti të shkojë.

APLIKIMET E FSHEHTËSISË

Kjo pjesë e "Sekretit" i thekson disa fusha në jetën tënde ku mund ta zbatosh sekretin dhe t'i tregon disa taktika për secilën fushë.



FSHEHTËSIA PËR PARATË

- Për të tërhequr para, përqendrohu në pasuri. Është e pamundur të sjellësh më shumë para në jetën tënde kur përqendrohesh në mungesën e tyre.
- Është e dobishme ta përdorësh imagjinatën tënde dhe të shtiresh sikur tashmë i ke paratë që i dëshiron. Luaj lojëra që e përmbajnë posedimin e pasurisë dhe do të ndihesh më mirë për paratë; ndërsa ndihesh më mirë për to, më shumë do të qarkullojnë në jetën tënde.
- Të ndihesh i lumtur tash është mënyra më e shpejtë të sjellësh para në jetën tënde.
- Bëje synim tëndin të shikosh gjithçka që të pëlqen dhe t'i thuash vetes, "Mund t'ia lejoj vetes atë. Mund ta blej atë." Do ta zhvendosësh të menduarit tënd dhe do të fillosh të **ndihesh** më mirë për paratë.
- Jep para ashtu që të sjellësh më shumë para në jetën tënde. Kur je zemërgjerë me paratë dhe ndihesh mirë për t'i ndarë ato me të tjerët, je duke thënë, "Kam me bollëk."
- Vizualizo çeqe (apo zarfe me para) në kutinë postare (apo transaksione që sjellin para në llogarinë tënde të bankës).
- Anoje balansin e mendimeve tua kah pasuria. Mendo pasuri.


Sekreti për Para
Krijimi i pasurisë ka të bëjë me atë se si mendon ti
Mos cakto qëllim të daljes nga borxhi sepse kjo do të të mbajë në borxh
Rregulloje një program automatik të shlyerjes së borxhit dhe fokusohu në prosperitet
Nëse dëshiron më shumë para përqendrohu në to dhe jo në mungesën e tyre
Vizualizoji paratë duke rrjedhë kah ti
Ndryshoji besimet e kufizuara për paratë me besime të bollëkut

FSHEHTËSIA PËR MARRËDHËNIET (LIDHJET DHE MIQËSITË)

- Kur dëshiron ta tërheqësh një marrëdhënie, sigurohu që mendimet, fjalët, veprimet, dhe ambienti yt nuk janë në kundërthënie me dëshirat e tua.
- Puna jote je ti. Nëse nuk e mbush veten së pari, nuk ke asgjë t'i japësh askujt.
- Trajtoje veten me dashuri dhe respekt, dhe do të tërheqësh njerëz që të shfaqin dashuri dhe respekt.
- Kur ndihesh keq për veten, ti e bllokon dashurinë dhe në vend të saj ti tërheq më shumë njerëz dhe situata që do të vazhdojnë të të bëjnë të ndihesh keq për veten.
- Përqendrohu në cilësitë që të pëlqejnë për veten dhe ligji i tërheqjes do të të tregojë më shumë gjëra të shkëlqyera për veten.
- Për ta bërë një lidhje të funksionojë, përqendrohu në atë se çka çmon te personi tjetër, dhe jo në ankesat e tua. Kur përqendrohesh te anët e mira, do të marrësh më shumë anë të mira.


Sekreti i Marrëdhënieve
Dije se çka je duke i dhënë marrëdhënies
Kënaqu me veten; Vetëm atëherë do të kënaqen të tjerët me ty
Trajtoje veten ashtu si don të të trajtojnë të tjerët
Fillo ta duash veten dhe do të dish t'i duash të tjerët
Ji i kënaqur dhe mund t'i kënaqësh të tjerët
Përqendrohu në anën e mirë të njerëzve përreth teje
Listoji (numëroji) cilësitë pozitive të njerëzve të afërt me ty
Nëse e realizon kontrollin tënd ndaj ndjenjave tua,
askush tjetër nuk duhet të ndryshojë për ty që të ndihesh mirë
Ti e krijon realitetin tënd dhe të tjerët të vetin

FSHEHTËSIA PËR SHËNDETIN

- Efekti placebo është shembull i ligjit të tërheqjes në veprim. Kur një pacient beson vërtet se pilula është mjekim, ai e pranon (merr) atë që e beson dhe shërohet.
- "Përqendrimi në shëndetin e përsosur" është diçka që të gjithë ne mund ta bëjmë brenda vetes, përkundër asaj që mund të jetë duke ndodhur jashtë.
- Qeshja tërheq gëzim, e shkarkon negativitetin, dhe çon në mjekime çudibërëse.
- Sëmundja mbahet në trup nga mendimi, nga vëzhgimi i sëmundjes, dhe nga vëmendja që i jepet sëmundjes. Nëse po ndihesh pak keq, mos fol për këtë – pos nëse dëshiron të ndihesh më keq. Nëse i dëgjon njerëzit duke folur për sëmundjen e tyre, ti i shton energji sëmundjes së tyre. Në vend të kësaj, kaloje bisedën në gjëra të mira, dhe jep mendime të fuqishme duke i parë të shëndetshëm ata njerëz.
- Besimet për plakjen janë të gjitha në mendjet tona, pra shkarkoji ato mendime nga vetëdija jote. Përqendrohu në shëndet dhe rini të përhershme.
- Mos i dëgjo mesazhet e shoqërisë për sëmundjet dhe plakjen. Mesazhet negative nuk të shërbejnë.


Sekreti i Shëndetit
Trupi yt është produkt i mendimeve dhe i ndjenjave tua
Mendja e njeriut luan rol të rëndësishëm në shërim
Arsyeja fundamentale për të gjitha sëmundjet është stresi
Sëmundjet janë tregues të perspektivës së çekuilibruar
Kur je i sëmurë, pos mjekimeve, hulumtoje se çka në mendjen tënde po e shkakton atë
Ji në gjendje të shëndetshme emocionale dhe sëmundja do ta lërë trupin
Le të përqendrohet mjeku në sëmundjen tënde, ti përqendrohu në trup të shëndetshëm
Jini shpresues sepse kjo i ndihmon shërimit
Ki mendime të lumtura dhe shmangiu mendimeve negative dhe stresit
Hiqe stresin fiziologjik dhe trupi do të shërohet vetë

FSHEHTËSIA PËR BOTËN

- Ajo të cilës i reziston, atë e tërheq, sepse je i përqendruar fuqishëm në të me emocion. Për të ndryshuar diçka, shko përbrenda dhe emeto sinjal të ri me mendimet dhe ndjenjat e tua.
- Nuk mund ta ndihmosh botën duke u përqendruar në gjëra negative. Ndërsa përqendrohesh në ngjarjet negative të botës, jo vetëm që i shton ato, por sjell po ashtu edhe më shumë gjëra negative në jetën tënde.
- Në vend se të përqendrohesh në problemet e botës, kushtoja vëmendjen dhe energjinë tënde mirëbesimit, dashurisë, begatisë, edukimit, dhe paqes.
- Kurrë nuk do të na harxhohen gjërat e mira sepse ka më shumë se mjaft për të gjithë. Jeta është destinuar të jetë e begatshme.
- E ke aftësinë të kesh qasje në furnizimin e pakufizuar përmes mendimeve dhe ndjenjave tua dhe ta sjellësh atë në përjetimin tënd.
- Lavdëro dhe beko gjithçka në botë, dhe do ta zhdukësh negativitetin dhe joharmoninë dhe do të bashkërenditesh me frekuencën më të lartë – dashurinë.



FSHEHTËSIA PËR TY

- Gjithçka është energji. Ti je magnet i energjisë, pra ti energjizon elektrikisht gjithçka kah ti dhe e energjizon elektrikisht veten kah gjithçka që dëshiron ti.
- Ti je qenie shpirtërore. Ti je energji, dhe energjia nuk mund të krijohet apo shkatërrohet – ajo vetëm e ndryshon formën. Prandaj, esenca e pastër e qenies tënde ka qenë gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë.
- Gjithësia shfaqet nga mendimi. Ne jemi krijues jo vetëm të fatit tonë por edhe të Gjithësisë.
- E ke në dispozicion një furnizim të pakufizuar të ideve. Tërë dija, zbulimet, dhe shpikjet janë në Mendjen Universale si mundësi, duke e pritur mendjen njerëzore t'i nxjerrë ato. Ti mban gjithçka në vetëdijen tënde.
- Ne jemi të gjithë të lidhur, dhe ne të gjithë jemi Një.
- Shkëputu nga vështirësitë nga e kaluara jote, kodet kulturore, dhe besimet shoqërore. Ti je i vetmi që mund ta krijosh jetën që e meriton.
- Një rrugë e shkurtër për te manifestimi i dëshirave tua është ta shohësh atë që e dëshiron si fakt absolut.
- Fuqia jote është në mendimet e tua, prandaj ji i vetëdijshëm. Me fjalë tjera, "Kujtohu të kujtohesh."


Sekreti për Ty
Gjithçka në univers, përfshirë edhe ty, është energji dhe është e lidhur si një fushë e energjisë
Ti je qenie shpirtërore
Ti ke potencial nga Zoti dhe fuqinë për ta krijuar botën tënde
Nuk ka kufij në arritje meqë ne jemi qenie të pakufizuara
Nëse nuk je i lumtur me atë se ku je në jetë atëherë ndryshoje tash
Përqendrohu në atë që e do dhe realizo
Nëse rrethanat të bëjnë të ndihesh si viktimë, përjetimet e tua nuk janë unike, prandaj tejkaloje ("lëshoje teposhtë").

FSHEHTËSIA PËR JETËN

- Ti e mbush dërrasën e zezë (tabelën shkollore) të jetës tënde me çkado që dëshiron ti.
- E vetmja gjë që nevojitet ta bësh është **të ndihesh mirë tash**.
- Sa më shumë që e përdor fuqinë brenda teje, aq më shumë fuqi do të tërheqësh kah ti.
- Koha për ta përqafuar madhështinë tënde është tani.
- Ne jemi në mes të një epoke të lavdishme. Ndërsa shkëputemi nga mendimet kufizuese, do ta përjetojmë madhështinë e vërtetë të njerëzimit, në çdo fushë të krijimit.
- Bëje atë që e do. Nëse nuk e di se çka të sjell gëzim, pyet, “Cili është gëzimi im?”. Ndërsa i përkushtohesh gëzimit tënd, do ta tërheqësh një ortek të gjërave të gëzueshme sepse je duke rrezatuar gëzim.
- Tash që e ke mësuar dijen e Fshehtësisë, çka bën me të varet nga ti. Çkado që zgjedh është në rregull. Fuqia është e tëra e jotja.


Sekreti i Jetës
Zoti nuk e ka paracaktuar qëllimin apo misionin tonë në jetë; ne e caktojmë, ne e krijojmë atë
Jeta është bërë (menduar) për të qenë e begatshme në të gjitha fushat
Synimi ynë primar është ta ndiejmë dhe ta përjetojmë gëzimin
Kërkoje lumturinë përbrenda, jo jashtë
Lumturia e brendshme është karburanti i suksesit
Realizo gëzim, vizion dhe paqe të brendshme dhe jashtësia krijohet automatikisht
Bëji vetëm ato gjëra që të sjellin gëzim
Nëse e përcjell harenë tënde do ta përcjellësh gjurmën për te begatia dhe suksesi në të gjitha fushat
Jetën tënde e ke zotëruar atëherë kur zëri dhe vizioni që është brenda është më i thellë se sa opinionet jashtë.


Sekreti nga Rhonda Byrne
Sekreti është Ligji i Tërheqjes
I përgjigjet mendimeve dhe ndjenjave tua për ta krijuar të ardhmen tënde
Ligji më i fuqishëm në Univers
Të jep gjithçka që ti do
Është duke punuar gjithmonë pavarësisht nga besimi dhe të kuptuarit
Nuk i intereson për perceptimin tënd të të mirës apo të keqes as a do ti apo nuk do
Është bazë e gjithësisë - p.sh. graviteti
Tërheqja është rezultat i mendimeve dhe i ndjenjave
Mendimet e tua
Formojnë imazhe në mendje
Janë vazhdimisht duke krijuar dhe ato bëhen gjëra
Tri tipe
Të kujtuarit - e kaluara
Të vëzhguarit - e tashmja
Imagjinimi - e ardhmja
Çdokush mund t'i ndryshojë mendimet e veta thjesht veç duke e ndryshuar përqendrimin (fokusin)
Mendimi pozitiv shumë herë më i fuqishëm se sa mendimi negativ - Pra rezultatet pozitive prodhohen më shpejt
Mendimet marrin ca kohë për t'u manifestuar duke dhënë amortizim për korrigjim të kursit - drejtimit.
Ndjenjat e tua
Mendimet shkaktojnë ndjenja
Të Ndihesh Mirë domethënë bashkërenditje me atë që e dëshirojmë dhe se jemi gati të pranojmë-marrim
Të Ndihesh Keq domethënë jo në bashkërenditje me atë që e duam dhe nuk jemi gati të pranojmë-marrim
Ndjenjat e tua i paraparëcaktojnë rezultatet e tua
Janë Sistemet e tua Udhërrëfyese Emocionale
Mendja është duke i formësuar rezultatet e tua në kohë reale.
Çka je tash është rezultat i mendimeve dhe i ndjenjave tua në të kaluarën
Çka mendon dhe ndien tash do të përputhet me rezultatin tënd në të ardhmen
Ajo në çka përqendrohesh, e deshte apo jo, manifestohet
Përqendrohu në atë që e do - kurrë mos u përqendro në atë që nuk e do.
Në vend të kësaj përqendrohu në të kundërtën e asaj që nuk e do.
Tërhiqe atë që e do duke i ndryshuar mendimet dhe ndjenjat e tua tash, udhëheqi mendimet e tua duke u bazuar në atë se si ndihesh me to për ta krijuar realitetin tënd
Përdorimi i Sekretit
Procesi Krijues
Ktheje Fantazinë në Fakt
Kalo në Fantazi më të mëdha
Bëje këtë përditë për të gjitha dëshirat e tua
Kërkoje atë që e do
Mendo për atë që e do, formoji ndjenjat, shkruaje diku, fol për të, vëje në skenë (aktroje), përjetoje, bëje realitet tëndin.
Jini të përqendruar në dëshirën me plot pasion
Beso se mund ta kesh, se është e mundur, dhe se e meriton
Universi do të ripërshtatet (riaranzhohet) për ta siguruar përgjigjen
Universi do të përgjigjet
Mos u shqetëso se si
Nuk ka periudhë të saktë kohore për përgjigjje
Mendja jonë i vendos kufijtë kohorë, jo universi
Ji gati për të pranuar
Shpreheni mirënjohjen duke e bërë një listë të gjërave për të cilat jeni mirënjohës
Çmuarja sjell më shumë përkrahje
Vizualizoje (përfytyroje, paramendoje) se e ke atë që e do dhe ndieji ndjenjat e posedimit të saj
Përdor Tabelë të Vizionit - Tabelë e thjeshtë në të cilën mund të vendosësh foto të gjërave që i dëshiron
Rri në ndjenjë të lumturisë për të tërhequr situata të mira
Ndryshoji ndjenjat e këqijia shpejt duke menduar diçka të mirë
Përjetoje ndjenjën e posedimit tash duke provuar, aktruar apo imagjinuar
Kur ke mendim të inspiruar, besoji dhe vepro në të
Kur shfaqet shansi, vepro me shpejtësi
Me shumë pasion dhe ndjenja të mira do ta shpejtojnë procesin
Bëje ambientin tënd të përputhet me dëshirat e tua

INFO

Burimet:

- Rhonda Byrne, The Secret
- Achievepedia, Esenca e dijes nga Sekreti

Ky publikim dhe publikime të tjera mund të gjenden online te:

- Pjesa Mirëqenie e faqes personale të Ridvan Bunjakut:
  http://sites.google.com/site/kalabuli/jetes%C3%AB
- Faqja e Sabir Krasniqit:
  http://sa-kra.ch/
- Grupi Energjia Pozitive në Facebook:
  http://www.facebook.com/groups/energjiapozitive/
- Faqja |:(|:) Publikimet RB në Facebook:
  http://www.facebook.com/pages/-Publikimet-RB/132542120116133